



**KOMUNA E PRISHTINËS**  
**RAPORT MUJOR**

Drejtoria	<b>Drejtoria e Arsimit</b>
Periudha Raportuese	<b>Nëntor 2018</b>
Emri dhe mbiemri i raportuesit	Fatos Osmani

**1. PËRMBLEDHJE**

Përmbledhje e përgjithshme rreth mbarëvajtjes/ecurisë së punës në drejtorinë tuaj për muajin raportues:

Drejtoria e Arsimit, gjatë muajit nëntor të vitit 2018, ka arritur me sukses t'i realizojë punët dhe detyrat të shumta, të parapara me planin e veprimit dhe njëkohësisht punë dhe detyra të tjera të paraqitura.

Pra, realizimi i punëve dhe detyrave të planifikuara ka reflektuar në shumë dimensione progresive për proceset arsimore.

**AKTIVITETET E PLANIFIKUARA**

Listoni aktivitetet për muajin raportues, të parapara me planprogramin e Komunës për drejtorinë tuaj:

- Mbikëqyrja e vazhdueshme e procesit edukativo-arsimor;
- Vizita të përgjithshme-këshilluese në institucionet arsimore;
- Krijimi i ekipeve në nivel të institucioneve edukative e arsimore për përgatitjen dhe koordinimin e procesit të vlerësimit të brendshëm dhe të jashtëm të performancës së shkollës;
- Sigurimi i koordinatorit të cilësisë në nivel komune dhe në nivel shkolle;
- Mbikëqyrja/ mentorimi i aktiveve profesionale (seksionet);

- Fuqizimi i aktiveve profesionale;
- Përmirësimi i planifikimit buxhetor (me të gjitha palët e interesit);
- Sigurimi i buxhetit adekuat për realizimin e objektivave të planit strategjik;
- Vizita studimore jashtë vendit për zyrtarët, drejtorët dhe mësimdhënësit, për të qenë në hap me ndryshimet dhe risitë arsimore në vendet e zhvilluara;
- Operimi i ekipit vlerësues profesional për fëmijët me nevoja të veçanta arsimore;
- Integrimi i fëmijëve me nevoja të veçanta në institucione edukativo-arsimore;
- Monitorimi dhe integrimi i fëmijëve me nevoja të veçanta dhe rekomandimet për adresim më efektiv të problemeve;
- Organizimi i mësimi joformal në tri nivelet e arsimit parauniversitar (në bashkëpunim me MASHT dhe Qendrën Rajonale të Aftësimi Profesional);
- Krijimi i një trupi komunal për bashkërendimin e përpjekjeve për përkrahjen dhe lehtësimin e zbatimit të kurrikulës;
- Aftësimi dhe informimi i mësimdhënësve dhe i nxënësve lidhur me vlerësimin e standardizuar;
- Sigurimi dhe menaxhimi i fondeve për përmirësimin e infrastrukturës, në përputhje me kërkesat për zbatim optimal të kurrikulës së re. Kryesisht sigurohen pajisjet dhe mjetet materiale për mësimdhënie dhe të nxënë cilësor në klasat dhe vitet që zbatojnë kurrikulën e re;
- P.sh. School Me, ose platforma online të të nxënës (2018 – pilotim);
- Trajnimi i mësimdhënësve;
- Identifikimi i organizatave, bizneseve dhe komunitetit në përgjithësi, që janë të interesuar të kontribuojnë në shkollë;
- Krijimi i mekanizmave brenda shkollave, të cilat do të jenë në komunikim të vazhdueshëm me këta donatorë;
- Rritja e llojeve të shërbimeve (dhe gjenerimi i të hyrave për rritje të numrit të fëmijëve të përfshirë në IP) të edukimit parashkollor;
- Zhvillimi i partneriteteve për rritjen e përfshirjes dhe sigurimin e kontributeve të jashtme;
- Angazhimi i psikologut, pedagogut, edukatorit mbështetës, pediatrit, nutricionisti e të tjerë në IP, me orar të organizuar sipas UA-së për numër të fëmijëve në IP;
- Ekipi komunal harton planin e përmirësimit për tejkalimin e problemeve dhe avancimin e standardeve të IP-ve në komunë;
- Përkrahja për përmirësimin e zbatimit të standardeve të EPSH-së;
- Sanksione të qarta dhe të zbatueshme për mësimdhënësit që ushtrojnë çfarëdo dhune dhe shkelje të të drejtave të fëmijëve në shkollë;

- Takimet të rregullta individuale me prindër;
- Angazhimi i prindërve në aktivitete jashtëkurrikulare;
- Prindërit angazhohen për krijimin e një mjedisi të sigurt në shkollë;
- DKA përkrah NNV dhe nxënësit me talente;
- Identifikimi i dhunës përmes pyetësorëve anonim;
- Ndërtimi i hapësirave të reja shkollore dhe renovimi e zgjerimi i hapësirave ekzistuese;
- Organizimi i ngjarje për vetëdijesimin e punëtorëve arsimorë për nevojën e krijimit të kushteve optimale të punës e mësimi nëpër shkolla;
- Organizimi i takimeve me organet e sigurisë;
- Sigurimi i të dhënave për planifikimin e buxhetit;
- Përgatitja e tenderëve për mallra dhe shërbime;
- Përgatitja e lëndëve për mallra dhe shërbime;
- Përcjellja dhe realizimi projekteve nga donatorët;
- Evidentimi i të hyrave vetanake;
- Nënaloqimet e pagave për institucionet shkollore;
- Nënaloqimet e mjeteve për mallra dhe shërbime në nënprograme;
- Shpenzimet komunale për institucionet shkollore;
- Pranimi i lëndëve për aprovim;
- Zotimi i lëndëve;
- Aprovimi i pagesave;
- Barazimi i pagesave me Freebalance;
- Përgatitja e planit për furnizim të shkollave fillore me libra nga klasa 1-9;
- Furnizimi i institucioneve edukativo-arsimore me inventar të shkollave;
- Furnizimi i institucioneve edukativo-arsimore në mënyrë sistematike me naftë, pelet;
- Furnizimi i nxënësve të nivelit të arsimit fillor me kiflet dhe qumësht;
- Furnizimi i institucioneve edukativo-arsimore me material didaktik dhe higjienike;
- Furnizimi me material didaktik i shkollave;

## 2. AKTIVITETET E IMPLEMENTUARA

Listoni dhe shpjegoni aktivitetet e implementuara gjatë periudhës raportuese nga drejtoria juaj, duke përfshirë edhe aktivitetet që janë në implementim e sipër. Theksoni të arriturat e Drejtorisë:

- Mbikëqyrja e procesit edukativo-arsimor në institucionet e nivelit të arsimit parauniversitar, është duke u realizuar në vazhdimësi nga zyrtarët e arsimit, të cilët sipas planit dinamik janë duke operuar në terren dhe duke i përcjellë nga

afër ecurinë e zhvillimeve në arsim dhe njëkohësisht duke i mbështetur shkollat me këshilla profesionale;

- Sipas dinamikës së planifikuar, zyrtarët e arsimit kanë realizuar planin operues, si: vizita informuese, speciale, kontrolluese dhe të përgjithshme në institucionet e nivelit të arsimit parauniversitar. Pra, në kuadër të mbikëqyrjes profesionale dhe kontrollit të vazhdueshëm të ecurive dhe zhvillimeve në procesin e institucioneve edukativo-arsimore të Komunës së Prishtinës, zyrtarët e Drejtorisë së Arsimit, sipas planifikimit dhe dinamikës së paraparë, gjatë muajit nëntor të vitit 2018 kanë realizuar planin e punës. Pra, në këtë periudhë raportuese janë realizuar 24 vizita mbështetëse dhe këshilluese në institucionet e nivelit të arsimit parauniversitar;
- Drejtoria e Arsimit, në funksion të zhvillimeve dhe përmirësimit të cilësisë në arsim, ka zgjedhur koordinatorin e cilësisë në nivel komune dhe njëkohësisht ka arritur t'i zgjedhë mbi 20 koordinatorë të shkollave, dhe në vijimësi është duke bërë përpjekje që në secilën shkollë të emërohet koordinatori i cilësisë, por në këtë pozitë të caktohen pedagogë të përgjithshëm;
- Aktivitetet profesionale (seksionet), në funksion të zhvillimeve të proceseve progresive në sistemin e arsimit dhe ngritjes së cilësisë në arsim, gjatë kësaj periudhe kanë realizuar punët dhe detyrat e përcaktuara dhe në fund muajit kanë përgatitë raporte mbi ecuritë dhe zhvillimet e përgjithshëm në shkollë. Po ashtu, aktivitetet profesionale në vazhdimësi janë duke u mbikëqyrë dhe mentoruar nga drejtuesit e shkollave përkatëse për punën e tyre, ndërsa, Drejtoria e Arsimit në vazhdimësi i ka mbështetur me këshilla profesionale aktivitetet profesionale dhe i ka informuar për rëndësinë e madhe që kanë në zhvillimin e arsimit dhe u ka përgatitë formën raportuese për punët dhe detyrat e realizuara për çdo muaj;
- Mësimi jo formal në të tri nivelet e arsimit parauniversitar, është duke u realizuar sipas planifikimit dhe dinamikës së paraparë;
- Organizimi dhe zhvillimi i mësimi joformal është duke u mbajtur në pesë institucione të nivelit të arsimit të mesëm të lartë dhe në një institucion të nivelit fillor dhe të mesëm të ulët. Ky proces në këto institucione është duke u zhvilluar sipas dinamikës dhe planifikimit të paraparë;
- Për vlerësimin e nxënësve-fëmijëve me nevoja të veçanta, ekipi profesional ka operuar sipas planifikimeve të parapara për adresimin e fëmijëve me nevoja të veçanta. Në këtë periudhë kohore janë vlerësuar nga ekipi vlerësues dy (2) nxënës-fëmijë, njëri fëmijë është me diagnozë autizëm dhe tjetri me probleme në të dëgjuar. Andaj, nxënësit janë rekomanduar që të vijojnë mësimet në shkollë të rregullt;
- Realizimi i praktikës profesionale me nxënësit e shkollave profesionale gjatë muajit nëntor është realizuar në një masë, por jo në nivel të kënaqshëm, kjo është si pasojë e disa faktorëve, si: mos gatishmëria e bizneseve për pranim të nxënësve, mungesa e transportit etj. Pra është indikativ fakti se praktika profesionale për nxënësit e shkollave profesionale është determinuese në zhvillimin dhe përgatitjen e tyre profesionale;

- Drejtoria e Arsimit, me kohë të duhur ka përcjellë Udhëzimin administrativ 08/2016, për vlerësimin e nxënësve sipas kornizës së Kurrikulës së arsimit parauniversitar të Republikës së Kosovës dhe njëkohësisht modelin sipas standardeve të kërkuara për vlerësim. Po ashtu, janë përcjellë edhe informata të tjera të domosdoshme në të gjitha institucionet e nivelit të arsimit parauniversitar dhe janë dhënë këshilla të nevojshme për këtë proces, por duhet theksuar se vlerësimi akoma mbetet sfidë dhe ka nevojë për mbështetje permanente;
- Në rast se ka tendencë për çfarëdo dhunë apo shkelje të të drejtave të fëmijëve-nxënësve në institucionet arsimore, drejtoria merr masa të menjëhershme komform legjislacionit në fuqi të Republikës së Kosovës dhe rregullores komunale për arsim;
- Drejtoria e Arsimit e Komunës së Prishtinës, pas analizës dhe vlerësimit të përgjithshëm mbi gjendje e reformave që janë duke u zhvilluar në sistemin e arsimit

parauniversitar dhe në veçanti zbatimin në praktikë të Kurrikulës së re, ka identifikuar se në këtë segment ka nevojë për mbështetje profesionale dhe në mënyrë permanente nga institucionet qendrore dhe ato lokale.

Andaj, DKA-ja për t'ju përgjigjur këtyre zhvillimeve që janë duke u zhvilluar në



sistemin e arsimit parauniversitar, ka ndërmarrë veprime konkrete në shumë dimensione, në mënyrë që proceset e filluar të gjejnë zbatueshmëri të duhur në institucionet tona.

Në funksion të këtyre zhvillimeve DKA-ja, në koordinim me drejtuesit e institucioneve edukativo-arsimore, kanë hartuar planin e bashkëpunimit në mes shkollave për vitin 2018-2019, duke inkorporuar tema esenciale, që janë determinuese për mbështetjen e proceseve reformuese, e që janë duke u zhvilluar në sistemin e arsimit parauniversitar.

Pra, roli kyç i këtij plani do të jetë forcimi dhe bashkëpunimi në mes shkollave, mësimdhënësve dhe aktiveve profesionale (seksioneve) të shkollave, duke shkëmbye përvoja dhe praktika të mira në mes veti, sepse mësimdhënësit janë promotor të këtyre zhvillimeve reformuese.

Andaj, bashkëpunimi në mes shkollave, aktiveve apo fushave të kurrikulës do të jenë të koordinuar mirë, në mënyrë që proceseve reformuese t'iu përgjigjemi bashkërisht dhe në mënyrë profesionale;

- Drejtoria e Arsimit, në bashkëpunim me organizatën “Save the Children” dhe OJQ “Syri i Vizionit”, në sallën e Kuvendit të Komunës u mbajt aktiviteti “Ri-strukturimi i Asamblesë Komunale të Fëmijëve”.



Asambleja e Fëmijëve në Prishtinë është themeluar më 15 qershor 2013 dhe është organ legjitim i përfaqësimit të fëmijëve në vendimmarrje në nivelin lokal dhe është ambient ku vazhdimisht promovohen

liritë dhe të drejtat e fëmijëve dhe përbëhet nga fëmijët asamblistë-përfaqësues



të shkollave të mesme të ulëta të Prishtinës.

- Vlerësimi i gjendjes përkitazi me funksionimin e paraleleve të ndara dhe shkollave të vogla rurale;  
Drejtoria e Arsimit, gjatë periudhës së qershorit ka realizuar një vlerësim të përgjithshëm mbi funksionimin e paraleleve të ndara dhe shkollave të vogla në zona rurale, ku numri i nxënësve në këto shkolla nga viti në vit është duke u zvogëluar. Andaj, si rezultat i këtyre trendëve negative dhe vlerësimit të përgjithshëm, paralelja e ndarë e shkollës fillore “Pjetër Bogdani”, është mbyllur, si rezultat i mungesës së nxënësve që e vijojnë procesin arsimor. Po ashtu, është duke u punuar në vazhdimësi që shkollat në zona rurale të fuzionohen në shkolla më të mëdha, sepse kjo do të ketë efekte pozitive në shumë dimensione, e veçanti në zhvillimin dhe socializimin e nxënësve, ngritjes

së konkurrencës dhe përmirësimit të cilësisë në mësimdhënie dhe mësimnxënie;

- Takime të rregullta me zyrtarë për arsim në DKA, për të trajtuar çështje me interes, e që ndërlidhen me ato të sigurisë në shkolla;
- Vizita në shkolla sipas kërkesave të shkollave, prindërve apo nxënësve;
- Grumbullimi i të dhënave, braktisja e nxënësve në shkollat fillore dhe ato të mesme për vitin shkollor 2017-2018;
- Përpunimi i të dhënave për numrin e nxënësve në shkollat në gjuhën serbe dhe numri i shkollave sipas niveleve për vitin shkollor 2018-2019;
- Vazhdimi i programit për avancimin e pedagogëve, të cilët mbajnë lëndë pedagogjike dhe akademike me kohëzgjatje 1 (një) vjeçare;
- Takim me palët e interesit dhe zyrtarë komunalë nga drejtoritë tjera përkatëse;
- Shqyrtimi dhe kthimi i përgjigjeve të të gjitha shkresave zyrtare të paraqitura gjatë muajit nëntor;
- Pjesëmarrja në procedurat e hapjes dhe vlerësimeve të tenderëve për nevojat e institucioneve arsimore. Në procesin e hapjes dhe vlerësim të tenderëve marrin pjesë gjithnjë nga tre përfaqësues të Drejtorisë së Arsimit;
- Në kohë të paraparë janë furnizuar të gjitha institucione edukativo-arsimore me lëndë djegëse dru dhe pelet;
- Janë furnizuar në vazhdimësi të gjitha institucionet me materiale didaktike, higjienike dhe mallra dhe shërbime tjera;
- Furnizimi me ushqim i kuzhinës qendrore;
- Furnizimi i institucioneve arsimore të nivelit fillor (I-V) me kiflet dhe qumësht;
- Janë furnizuar disa institucione edukativo-arsimore me inventar të nevojshëm;
- Ndarja e buxhetit sipas programeve dhe nënprogrameve;
- Janë nënalokuar pagat për 64 institucione shkollore;
- Janë nënalokuar mjetet për mallra dhe shërbime për programe dhe nënprograme;
- Janë zotuar 190 lëndë për mallra dhe shërbime si shërbime komunale;
- Janë shpenzuar dhe certifikuar 190 lëndë;
- Aprovimi i kërkesave të institucioneve shkollore lidhur me shpenzime nën 100 Euro;
- Mbajtja e evidencës për lëndët e zotuar me modul blerjes si dhe dorëzimi në prokurim.

### 3. AKTIVITETET NË IMPLEMENTIM E SIPËR

Të përshkruhen në detaje aktivitetet që janë në implementim e sipër nga drejtoria juaj për muajin raportues:

- Vizita të vazhdueshme, të përgjithshme, kontrolluese dhe speciale në institucionet edukativo-arsimore;
- Formohet asociacioni i drejtorëve të shkollave që funksionojnë si trup në sigurim të cilësisë;
- Përcjellja e shpenzimit të buxhetit sipas planifikimit;
- Menaxhimi i kontratave për mallra dhe shërbime;
- Kontrollimi i shpenzimeve për të gjitha institucionet shkollore;
- Kontrollimi i shpenzimeve (subvencioneve) në Institucionet Parashkollore me bazë në komunitet.

### 3.1.1. STATISTIKAT

Të listohen të gjitha statistikat përkatëse për drejtorinë tuaj, duke filluar nga buxheti i planifikuar dhe ai i shpenzuar për periudhën raportuese, diskutimet publike, takimet me palë, institucione, qytetarë e të ngjashme, kërkesat për qasje në dokumente zyrtare, lëndët e pranuar, të kryera dhe në përfundim e sipër, dhe statistika të tjera specifike që mund të ketë drejtoria juaj. Shtoni kategoritë sipas nevojës.

### 3.1.2. Buxheti i planifikuar dhe ai i shpenzuar për periudhën raportuese, nëntor 2018

<b>Buxheti i shpenzuar dhe alokuar 11-2018</b>				
<b>Kategoria Eko.</b>	<b>Alokim</b>	<b>Shpenzim</b>	<b>Zotim - Obligim</b>	<b>Mbetje -S=</b>
<b>Paga</b>	1,575,214.52	1,575,214.52	-	-
<b>Komunali</b>	32,452.73	21,127.49	11,324.72	0.52
<b>10-21 MSH</b>	169,236.00	59,871.00	80,365.90	28,999.10
<b>Subvencione</b>	35,845.00	2,456.00	17,125.00	16,264.00
<b>Donacione</b>	47,239.23	2,000.00	-	45,239.23
<b>Investimet kapitale</b>	662,542.74	158,962.00	420,545.00	83,035.74
<b>Gjithsej:</b>	<b>2,522,530.22</b>	<b>1,819,631.01</b>	<b>529,360.62</b>	<b>173,538.59</b>

### 3.1.3. Takimet me palë:



- Drejtoria e Arsimit, gjatë muajit nëntor ka realizuar mbi 134 takime me palë;
- Takimet me palë në Drejtorinë e Arsimit janë të planifikuara katër ditë në javë.

#### 4. Takimet me institucione të tjera

Për periudhën e muajit nëntor të vitit 2018, janë realizuar takime me:

- zyrtarët e Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë;
- përfaqësuesit e UNICEF;
- përfaqësuesit e FSK-së;
- Ministrinë e Financave;
- përfaqësuesit e KUR "Prishtina";
- auditorët;
- përfaqësuesit e ndërmarrjes "Termokos";
- përfaqësuesit e KEDS;
- MAPL-së;
- përfaqësuesit e PTT-së.

##### 4.1.1. Diskutime publike/takimet me qytetarë

#### 5. Kërkesat për qasje në dokumente zyrtare:

- Gjatë muajit nëntor në Drejtorinë e Arsimit nuk është adresuar ndonjë kërkesë për qasje në dokumente zyrtare.

##### 5.1.1. Lëndët e pranuar, të kryera dhe në përfundim e sipër:

- Gjatë muajit nëntor janë pranuar gjithsej 54 lëndë, prej tyre të miratuara janë 26 lëndë, të refuzuara 12, të pezulluara 3, dhe në proces janë 13 lëndë.

#### 6. Takime të tjera:

- Takime me drejtues të institucioneve edukativo-arsimore;
- Takime me mësimdhënës;
- Takim me përfaqësues të prindërve të shkollave të caktuara;
- Takim me përfaqësues të këshillave drejtues të institucioneve edukativo-arsimore.

#### 7. SFIDAT

Nëse gjatë implementimit të planeve është hasur në vështirësi të ndryshme, p.sh. pengesa brenda drejtorisë, Komunës apo institucioneve të ndryshme, ju lutem shpjegoni në këtë hapësirë.

- Riorganizimi dhe përcaktimi i përgjegjësive, punëve dhe detyrave në Drejtorinë e Arsimit;
- Mungesa e një stafit profesional mbikëqyrës të veprimtarisë edukativo-arsimore;
- Mungesa e një mekanizmi për vlerësimin e performancës të stafit edukativo-arsimor;
- Numri i vogël i nxënësve në disa shkolla të viseve rurale;
- Kompetenca të përziera dhe jo të qarta;
- Kushtet jo optimale të punës për stafin e Drejtorisë së Arsimit, gjë që po reflekton drejtpërsëdrejti në cilësinë dhe realizimin e punëve dhe detyrave;
- Implementimi i Kurrikulës së re.

## 8. REKOMANDIME

Shënoni rekomandime rreth përmirësimit të mbarëvajtjes së proceseve, nëse keni, dhe nevojave të drejtorisë për të gjitha aspektet, p.sh. trajnime të punëtorëve, furnizim me pajisje shtesë, etj.

- Riorganizimi i menjëhershëm i Drejtorisë Komunale të Arsimit, në bazë të përgjegjësive, punëve dhe detyrave që ka kjo drejtori;
- Plotësimi i stafit profesional sipas kërkesave dhe nevojave të Drejtorisë së Arsimit;
- Formimi i një organi mbikëqyrës të performancës së veprimtarisë edukativo-arsimore;
- Riorganizimi i rrjetit shkollor të viseve rurale të Komunës së Prishtinës.
- Përmirësimi i pozitës materiale të stafit profesional të Drejtorisë së Arsimit.

## 9. AKTIVITETET E PLANIFIKUARA PËR MUAJIN PASUES

Listoni aktivitetet e planifikuara për drejtorinë tuaj për muajin pasues

- Mbikëqyrja e procesit edukativo-arsimor;
- Vizita sistematike në institucionet edukativo-arsimore;
- Vizita speciale IEAA;
- Kontrollim dhe monitorim i rregullt institucioneve parashkollore sipas dinamikës së planifikimit;
- Krijimi i ekipit profesional në nivel të DKA-së për monitorimin e përkrahjen e vlerësimit të performancës së shkollës;
- Formohet Asociacioni i drejtorëve të shkollave që funksionojnë si trup në sigurim të cilësisë;

- Sigurohet koordinatori i cilësisë në nivel komune dhe në nivel shkolle;
- Mbikëqyrja/ mentorimi i aktiveve profesionale (seksionet);
- Fuqizimi i aktiveve profesionale;
- Nënshkrimi i marrëveshjeve për punë praktike;
- Përmirësimi i planifikimit buxhetor (me të gjitha palët e interesit);
- Vizita studimore jashtë vendit për zyrtarët, drejtorët dhe mësimdhënësit për të qenë në hap me ndryshimet dhe risitë arsimore në vendet e zhvilluara;
- Operimi i ekipit vlerësues profesional për fëmijët me nevoja të veçanta arsimore;
- Integrimi i fëmijëve me nevoja të veçanta në institucione edukativo-arsimore;
- Monitorimi dhe integrimi i fëmijëve me nevoja të veçanta dhe rekomandimet për adresim më efektiv të problemeve;
- Organizimi i mësimi joformal në tri nivelet e arsimit (në bashkëpunim me MASHT dhe Qendrën Rajonale të Aftësisit Profesional);
- Monitorimi i zbatimit të Kurrikulës;
- Hartimi i kurrikulave të AAP;
- Krijimi i mekanizmave për nxitjen e përkrahjes dhe motivimit të mësimdhënësve për zbatim të Kurrikulës;
- Aftësimi dhe informimi i mësimdhënësve dhe i nxënësve lidhur me vlerësimin e standardizuar;
- Sigurimi dhe menaxhimi i fondeve për përmirësimin e infrastrukturës, në përputhje me kërkesat për zbatim optimal të Kurrikulës së re. Kryesisht sigurohen pajisjet dhe mjetet materiale për mësimdhënie dhe të nxënë cilësor në klasat dhe vitet që zbatojnë
- Kurrikulën e re;
- Kontraktimi i një kompanie nga Komuna për rregullimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve të TIK-ut në shkolla;
- P.sh. School Me, ose platforma online e të nxënit (2018 – pilotim);
- Trajnimi i mësimdhënësve;
- Identifikimi i organizatave, bizneseve dhe komunitetit në përgjithësi që janë të interesuar të kontribuojnë në shkolla;
- Krijimi i mekanizmave brenda shkollave, të cilat do të jenë në komunikim të vazhdueshëm me këta donatorë;
- Rritja e llojeve të shërbimeve (dhe gjenerimi i të hyrave për rritje të numrit të fëmijëve të përfshirë në IP) të edukimit parashkollor;
- Zhvillimi i partneriteteve për rritjen e përfshirjes dhe sigurimin e kontributeve të jashtme;

- Angazhimi i psikologut, pedagogut, edukatorit mbështetës, pediatri, nutricionisti e të tjerë në IP, me orar të organizuar sipas UA për numër të fëmijëve në IP;
- Ekipi komunal harton planin e përmirësimit për tejkalimin e problemeve dhe avancimin e standardeve të IP-ve në komunë;
- Përkrahja për përmirësimin e zbatimit të standardeve të EPSH;
- Sanksione të qarta dhe të zbatueshme për mësimmdhënësit, që ushtrojnë çfarëdo dhune dhe shkelje të të drejtave të fëmijëve në shkollë;
- Takimet të rregullta individuale me prindër;
- Angazhimi i prindërve në aktivitete jashtëkurrikulare;
- Prindërit angazhohen për krijimin e një mjedisi të sigurt në shkollë;
- DKA përkrah NNV dhe nxënësit me talente;
- Ndërtimi i hapësirave të reja shkollore dhe renovimi dhe zgjerimi i hapësirave ekzistuese;
- Furnizimi në mënyrë sistematike i shkollave me kiflet dhe qumësht;
- Furnizimi i vazhdueshëm i të gjitha institucioneve edukativo-arsimore me lëndë djegëse dru dhe pelet;
- Furnizimi i institucioneve edukativo-arsimore në mënyrë sistematike me materialet të nevojshme didaktike, higjienike, ushqim;
- Furnizimi i disa institucioneve edukativo-arsimore me perde;
- Organizimi i takimeve me organet e sigurisë.

## 10. TË TJERA

Shënoni çështje të tjera që mendoni se janë me rëndësi të raportohen e që nuk kanë qenë të përfshira në pikat e mësipërme: